

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, në çështjen juridike të paditësit KEP Trust, dega në Ferizaj, kundër të paditurve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], që të dy nga Ferizaj, Rr. [REDAKTUAR] p.n., për shkak të pagimit të borgjit nga marrëveshja e kredisë, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 19.11.2018, merrë këtë:

### **A K T G J Y K I M**

*- për shkak të padëgjueshmërisë / mosbindjes -*

**APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit KEP Trust, dega në Ferizaj dhe **DETYROHEN** të paditurit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], që të dy nga Ferizaj, që paditësit KEP Trust – dega në Ferizaj, në mënyrë solidare t'ia kthejnë borgjin në shumë prej **3,402.56 €** (tremijë e katërqind e dy euro e pesëdhjetë e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 40.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit me forcë.

### **A r s y e t i m i**

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 08.10.2018 ka ushtruar padi kundër të paditurve, për pagimin e borgjit, të krijuar me kontratë mbi huanë. Në padi paditësi ka deklaruar se i padituri [REDAKTUAR] është kredimarrës ndërsa e paditura [REDAKTUAR] është bashkë-kredimarrëse, të cilët me datën 23.03.2018 kanë marrur kredi nga paditësi në shumë prej 3,000.00 € me kamatë vjetore të interesit prej 27.99 %, mirëpo paditësit kanë ndërprerë kthimin e kredisë dhe tani borgji total i papaguar i të paditurve figuron në shumë prej 3,402.56 € (tremijë e katërqind e dy euro e pesëdhjetë e gjashtë cent) andaj i propozoj gjykatës që të bëjë administrimin e provave dhe të miratojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar, duke i detyruar të paditurit që ta paguajnë borgjin e mbetur me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

Për të mbështetur kërkespadinë e sajë, pala paditëse ka paraqitur provat si vijojnë: Marrëveshjen për Kredinë Nr. KOFE-15942-001 të datës 23.03.2018 të lidhur në mes të paditësit si kredidhënës dhe të paditurve si kredimarrës; Shtojcën Nr.2 e dt. 23.03.2018 me të cilin është paraparë plani dhe periudha e kthimit të kredisë brenda 24 muajve.

Gjykata, të paditurve, me datë 23.10.2018 u'a ka dërguar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditësit, por të paditurit, ndonëse i kanë pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesat e nënshkuara nga të paditurit personalisht me datë 26.10.2018) brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk kanë ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tyre nëse e kundërshtojnë apo jo kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësi.


Gjykata, nisur nga arsyet e lartëcekura, konform nenit 150 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore Gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452.1 të LPK-së.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.954/18, me datë 19.11.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVO  
VENTIMI ËSHTË I PLOTËDITSHËM  
DOKUMENTI JE PËRKYQENSHËM  
GJYKATA THEMELORE I OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC



Gjyqtari,  
Enes Mehmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.